

Në bazë të nenit 13. pika 4. të Ligjit për lojrat e fatit (Nr. 04/L-080), Lotaria e Kosovës miraton

RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES NË LOJËN E FATIT LOTO 7/39 TË LOTARISË SË KOSOVËS NËPËRMJET INTERNETIT

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me Rregullat e përgjithshme të pjesëmarrjes në lojën e fatit Loto 7/39 dhe Joker të Lotarisë së Kosovës nëpërmjet internetit (në tekstin e mëtejme: Rregullat e përgjithshme) përcaktohen dhe rregullohen raportet kontraktuale ndërmjet Lotarisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: organizatori) dhe personit fizik të regjistruar si pjesëmarrës në lojë (në tekstin e mëtejme: lojtari).

Neni 2

Raportet kontraktuale ndërmjet organizatorit dhe lojtarit hyjnë në fuqi pas përfundimit të suksesshëm të regjistrimit (neni 5 dhe 6 i Rregullave të përgjithshme), në ç'mënyrë lojtari pranon këto Rregulla të përgjithshme. Raportet kontraktuale lidhen për kohë të pacaktuar dhe secila palë kontraktuese mund të heqë dorë (neni 18 i Rregullave të përgjithshme).

Neni 3

Këto Rregulla të përgjithshme, si dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet fusha e organizimit të lojërave të fatit, paraqesin kornizën e tërësishme juridike për organizimin dhe pjesëmarrjen në lojëra nëpërmjet Internetit.

PËRKUFIZIMI I NOCIONEVE

Neni 4

Në mbështetje të Rregullave të përgjithshme, disa nocione kanë këtë kuptim:

Loja nëpërmjet kanaleve komunikuese interaktive (loja në distancë, loja online) - është pjesëmarrje në lojën e fatit Loto 7/39 dhe Joker nëpërmjet Internetit, ku lojtari mund të luajë në mënyrë të pavarur, pa përfaqësues të drejtpërdrejtë të organizatorit.

Sistemi i organizimit – është sistem kompjuterik ose sistem i kompjuterëve të organizatorit, nëpërmjet të cilëve organizohet loja, ndërsa përfshin sistemet operative dhe mbështetjen programore të aplikimit.

Emri i shfrytëzuesit – është kombinim unik i shenjave (emër) me të cilin sistemi evidenton lojtarin, e bashkë me fjalëkalimin shfrytëzohet për qasje në sistemin e organizimit.

Fjalëkalimi - është kombinim numrash e shkronjash që paraqet verifikimin e identitetit të lojtarit me rastin e qasjes dhe përdorimit të sistemit të organizimit.

Llogaria LK(Llogaria e lojtarit në Lotarinë së Kosovës) - është llogari unike virtuale e lojtarit, e caktuar nga ana e organizatorit në sistemin qendror të organizimit. Përbrenda llogarisë LK evidentohen të gjitha transaksionet financiare dhe transaksionet e lojës (konfirmimi -e) si dhe të gjitha shënimet dhe parametrat që lojtari i ka paraqitur me rastin e regjistrimit ose ndërkohë i ka ndryshuar.

Konfirmimi elektronik i pagesës (konfirmimi - e) - është shënim elektronik i konfirmimit të pagesës së lojës, i shënjuar me numrin identifikues të lojtarit që ndodhet në llogarinë LK të lojtarit në sistemin qendror të organizatorit.

Mbushja - është vërtetim mbi pagesën nga ana e lojtarit, e bërë në pikat e shitjes të Lotarisë së Kosovës në shumën përkatëse në euro dhe me kodin aktivizues. Duke dhënë kodin aktivizues në rubrikën **Mbushja e llogarisë**, lojtari e bart vlerën përkatëse si deponim në llogarinë e vet.

Bonuset - paraqesin mjetet për promocionin e lojërave që i jep organizatori në llogarinë LK të lojtarit. Bonuset mund të shfrytëzohen vetëm për pagesën e lojës dhe nuk mund të tërhiqen nga llogaria LK.

Kodi Verifikues - është kombinim shenjash që lojtarit i shërben për tërheqjen e fitimeve. Kodin Verifikues lojtari duhet ta përdor në rastin e tërheqjes së fitimeve në pikat e shitjes së Lotarisë së Kosovës.

Zgjedhje e shpejtë e kombinimit (QP) - është mënyrë e shpejtë e zgjedhjes së rastësishme të kombinimit të numrave nga ana e programit kompjuterik.

Kombinimi im i preferuar, është mënyrë e shpejtë e zgjedhjes së ndonjë kombinimi të preferuar.

Përsëriti tiketën e fundit të paguar - është mundësi më e shpejtë e luajtjes së tiketës së fundit të paguar.

Fshije kombinimin (tiketën) e luajtur, është mundësi më e shpejtë e anulimit të kombinimit (tiketës) së luajtur.

REGJISTRIMI I LOJTARIT

Kushtet e regjistrimit

Neni 5

Për lojë nëpërmjet kanaleve interaktive mund të regjistrohen vetëm shtetasit e moshës madhore të Republikës së Kosovës të cilët kanë adresë valide të postës elektronike (e-mail) dhe numër personal.

Procedura e regjistrimit

Neni 6

Regjistrimi i lojtarit është proces i regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave të lojtarit në sistemin kompjuterik të organizatorit. Gjatë procesit të regjistrimit lojtari është i obliguar që me saktësi dhe tërësisht të plotësojë formularin përkatës për regjistrim me të dhënat e kërkuara.

TË DHËNAT PERSONALE: emri dhe mbiemri, numri personal, data e lindjes, adresa, vendi dhe numri postar.

TË DHËNAT KONTAKTUESE: Emri i shfrytëzuesit, fjalëkalimi, pyetja dhe përgjigjja e sigurisë, adresa e postës elektronike (e-maili), telefoni (nëse dëshiron) dhe mënyra e komunikimit. Pas hapit të parë, organizatori identifikon personin duke verifikuar të dhënat personale nëpërmjet shërbimit elektronik. Verifikohet saktësia e të dhënave personale dhe konstatohet se a është personi fizik i moshës madhore. Lojtari që nuk i pranon këto rregulla të përgjithshme nuk mund të regjistrohet.

MENAXHIMI I LLOGARISË LK

Qasja në llogarinë LK

Neni 7

Lojtari në llogarinë e vet LK mund të qaset vetëm me emrin e shfrytëzuesit dhe fjalëkalimin e duhur. Lojtari është i obliguar të ruajë emrin e vet të shfrytëzuesit dhe fjalëkalimin, dhe vetë mban përgjegjësi për pasoja materiale dhe jo materiale të menaxhimit të llogarisë LK si dhe për keqpërdorimin e saj nga ana e personave të paautorizuar.

Lojtari siguron dhe obligohet që nuk:

- do të shfrytëzojë kanale interaktive për lojë në mënyra që nuk janë në harmoni me rregullat pozitive juridike të Republikës së Kosovës,
- do të veprojë në emër të personit tjetër,
- do të paguajë mjete të fituara nëpërmjet aktiviteteve kriminale dhe/ose aktiviteteve të tjera ilegale,

Financat

Neni 8

Organizatori në rubrikën **Financat**, lojtarit do t'i ofrojë pasqyrën e të gjitha transaksioneve financiare – mbushjet në llogarinë LK dhe tërheqjet nga llogaria LK me kohën e saktë të kryerjes së transaksioneve të caktuara, kufizimet eventuale për transaksion, si dhe pasqyrën përmbledhëse të strukturës së atyre mjeteve. Nga rubrika **Financat** bëhen deponimi i mjeteve financiare në llogarinë LK dhe tërheqja e mjeteve financiare nga llogaria LK.

Deponimi në llogarinë LK

Neni 9

Deponimi i mjeteve nga ana e lojtarit në llogarinë LK bëhet duke shtypur kodin aktivizues në rubrikën **Mbushja e llogarisë**. Mjetet e paguara lojtari do t'i ketë në dispozicion pasi të jenë deponuar në llogarinë LK të lojtarit. Me rastin e deponimit të mjeteve në llogarinë LK, organizatori nuk kërkon kompensim.

Pagesa për pjesëmarrje në lojë nga llogaria LK

Neni 10

Para pagesës për pjesëmarrje në lojë, lojtari duhet të ketë të deponuara mjete të mjaftueshme në llogarinë e vet LK. Nëpërmjet aktit të konfirmimit të shumëfishtë të pagesës së lojës, lojtari konfirmon pjesëmarrjen e tij në lojë. Pagesa e lojës-tiketës evidentohet si transaksion financiar duke ulur gjendjen e llogarisë LK. Transaksioni i kryer i pagesës së lojës nuk mund të anulohet. Nëse lojtari disponon mjete për lojë nga burime të ndryshme (deponimet që ka bërë në llogarinë LK, fitimet dhe bonuset), sistemi i organizimit së pari do të shfrytëzojë bonuset, pastaj mjetet e deponuara dhe në fund mjetet nga fitimet.

Pagesa e fitimeve në llogarinë LK

Neni 11

Çdo fitim të lojtarit sistemi i organizimit do ta bartë në llogarinë e tij LK. Organizatori nuk llogarit kompensim me rastin e pagesës së fitimeve në llogarinë LK të lojtarit. Organizatori ka të drejtë të korrigjojë transaksionin financiar të fitimit të paguar në LK të lojtarit, nëse pagesa është bërë si pasojë e gabimit teknik ose si pasojë e evidentimit të gabuar të rezultatit, duke kthyer mjetet e derdhura (të evidentuara) gabimisht.

Pagesa nga llogaria LK

Neni 12

Nga llogaria LK mund të paguhen vetëm mjetet në dispozicion për pagesë. Në mjetet në dispozicion për pagesë evidentohen fitimet. Përgatitja për tërheqje bëhet nga vet lojtari në rubrikën **Financat** duke shtypur **tërheqje nga llogaria** dhe shumën e dëshiruar për tërheqje. Nga sistemi i organizatorit lojtari pranon kodin për tërheqjen e mjeteve të cilin e tregon në pikën e shitjes dhe në bazë të këtij kodi i bëhet pagesa. Pagesa nga llogaria LK deri në shumën 400.00 euro bëhet në pikat e shitjes, kurse mbi këtë shumë pagesa bëhet në selinë e Lotarisë së Kosovës. Shumën e deponuar në llogarinë LK lojtari mund ta tërheq vetëm pas periudhës prej pesë muajve nga dita e deponimit. Organizatori pas kërkesës së lojtarit për kthimin e mjeteve të deponuara në llogarinë LK, obligohet t'ia paguaj duke ndalur më parë 5% të shumës për kthim, si shpenzim administrativ. Organizatori nuk ka mundësi të disponoj me mjetet e deponuara në atë llogari.

Profili im

Neni 13

Organizuesi në rubrikën **Profili im** do t'i ofrojë lojtarit pasqyrën dhe mundësinë e rregullimit të të dhënave personale të llogarisë LK nëpërmjet opsioneve:

- shënimet e shfrytëzuesit (të dhënat personale, të dhënat për kontakt),
- deaktivizimi.

Të dhënat e shfrytëzuesit

Neni 14

Të dhënat e shfrytëzuesit përfshijnë të dhënat personale, adresën dhe numrin e telefonit të shënuara me rastin e regjistrimit ose me rastin e ndryshimit të tyre. Nëse ndodh që lojtari të harrojë fjalëkalimin dhe kërkon ndërrimin e tij, organizatori do të dërgojë e-mail me fjalëkalim të ri, të cilin lojtari ndërkohë mund ta ndryshojë në rubrikën **Profili im**.

Deaktivizimi

Neni 15

Organizatori në rubrikën **Deaktivizimi** do t'i sigurojë lojtarit mundësinë e deaktivizimit nga loja për një periudhë të caktuar kohore, dhe kjo për 1 muaj, 3 muaj dhe 1 vit, ose përgjithmonë. Deaktivizimi bëhet nëse lojtari klikon në njërin nga opsionet e shënuar më lart. Gjatë kohës sa

zgjat deaktivizimi lojtari do të ketë menaxhim të kufizuar të llogarisë LK, domethënë nuk do të ketë mundësi të bëjë pagesën e lojës. Fitimet nga loja e fatit Loto 7/39 dhe Joker, të paguara më herët e të realizuara gjatë kohës së zgjatjes së deaktivizimit, do të derdhen në llogarinë LK të lojtarit.

Historia e Lojës

Neni 16

Organizatori në rubrikën **Historia e Lojës** do të sigurojë qasje në evidencën e tërësishme të tiketave të paguara, të shumës së paguar dhe të fitimeve të realizuara. Duke zgjedhur llojin-statusin e tiketës dhe periudhën kohore, lojtari ka mundësi të filtrojë të dhënat nga evidenca e vet. Organizatori do t'i sigurojë lojtarit qasje në detajet e çdo xhiroje dhe tikete të paguar si dhe mundësitë shtesë si: përsëritja e tiketës së fundit dhe pasqyra e llojeve të fitimeve.

Financat

Neni 17

Organizatori në rubrikën **Financat** do të sigurojë pasqyrën e evidencës së të gjitha transaksioneve financiare në llogarinë LK dhe nga llogaria LK.

Qasja e kufizuar ose mosqasja në llogarinë LK

Neni 18

Organizatori ka të drejtë përkohësisht të kufizojë qasjen ose mosqasjen në llogarinë LK të lojtarit, nëse konstaton:

- mospërbushjen e kushteve nga neni 5 i këtyre Rregullave të përgjithshme,
- mospërbushjen e kushteve nga neni 7 i këtyre Rregullave të përgjithshme,
- në çdo rast tjetër të paraparë me këto Rregulla të përgjithshme.

Qasja e kufizuar ose mosqasja në llogarinë LK do të ndërpritet kur të mos ekzistojnë më arsyet për zbatimin e kësaj mase.

Mbyllja e llogarisë LK

Neni 19

Mbyllja e llogarisë LK është heqja e lojtarit nga sistemi i organizimit. Kërkesën për mbylljen e llogarisë LK lojtari mund ta paraqesë, pa theksuar arsyet, në çdo kohë. Në procesin e mbylljes së llogarisë LK, lojtari duhet të përgatit tërheqjen e shumës që ka në dispozicion (sipas nenit 12). Llogarinë LK të mbyllur njëherë, lojtari mund ta hapë sërish sipas rregullave(**procedurës**) të parapara për regjistrim. Organizatori ka të drejtë të mbyllë llogarinë LK të lojtarit nëse nuk plotëson kushtet e parapara me këto Rregulla të përgjithshme.

Njoftime

Neni 20

Organizatori në faqet e veta të internetit do të publikojë njoftimet lidhur me ndryshimet e funksionalitetit të llogarive LK dhe sistemin e organizimit. Organizatori mban të drejtën të kontaktojë drejtpërdrejt lojtarin në raste të rëndësishme për shfrytëzimin personal të sistemit.

Pranimi dhe publikimi i Rregullave të përgjithshme

Neni 21

Lojtari i pranon këto Rregulla të përgjithshme në faqet e internetit të organizatorit gjatë procesit të regjistrimit, duke klikuar në shenjën përkatëse të miratimit. Pranimi i këtyre rregullave është shkruar në sistemin e organizatorit në kuadër të të dhënave të shfrytëzuesit të çdo lojtari të regjistruar. Duke pranuar këto rregulla, lojtari jep pëlqimin e tij të prerë për mbledhjen e të dhënave nga neni 6 i këtyre Rregullave të përgjithshme dhe përpunimin e tyre me qëllim të pjesëmarrjes në lojën e fatit Loto 7/39 dhe Joker, duke shfrytëzuar kanalet interaktive të komunikimit. Nëse lojtari nuk i pranon këto Rregulla të përgjithshme, konsiderohet se ai heq dorë nga regjistrimi i tij në sistemin e organizatorit. Lojtari duke pranuar këto Rregulla të përgjithshme jep pëlqimin edhe për të gjitha ndërrimet, plotësimet dhe ndryshimet e ardhshme të këtyre Rregullave të përgjithshme. Organizatori obligohet që në faqet e veta të internetit të publikojë çdo version të vlefshëm të Rregullave të përgjithshme si edhe të gjitha versionet paraprake.

MBROJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE

Të dhënat personale

Neni 22

Organizatori obligohet të mbledhë, të përpunojë dhe të ruajë të dhënat personale për lojtarët dhe llogaritë e tyre LK vetëm për qëllime të pjesëmarrjes së lojtarëve në lojën e fatit Loto 7/39 dhe Joker. Organizatori do të ruajë këto të dhëna si sekret afarist, si dhe do t'i përdorë ato në harmoni me rregullat e dispozitave ligjore në fuqi si dhe me këto Rregulla të përgjithshme.

Organizatori ndërmerr masa të qëndrueshme për mbrojtjen e të dhënave personale nga keqpërdorimi, dëmtimi, humbja, ndryshimi ose qasja e paautorizuar në to. Me kërkesë të organizatorit, për qëllime të verifikimit të identitetit ose të moshës madhore, lojtari është i obliguar të ofrojë dokumentin e tij identifikues për shikim.

Fjalëkalimi dhe pyetja e sigurisë

Neni 23

Lojtari obligohet të ruajë sekretin e fjalëkalimit të tij, sepse atë e di vetëm ai (atë nuk e di dhe as nuk ka qasje organizatori) prandaj vetë është përgjegjës për tërë rrezikun e keqpërdorimit eventual të tij. Lojtari obligohet të ruajë sekretin e përgjigjes së pyetjes së sigurisë, që përdoret si verifikim shtesë të sigurisë gjatë veprimeve përkatëse të konstatimit të identitetit.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Këto Rregulla të përgjithshme dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e ardhshme organizatori do t'i publikojë në faqen e vet të internetit. Ndryshimet e Rregullave të përgjithshme që janë në të mirë të lojtarëve zbatohen menjëherë. Në rast të ndryshimit të Rregullave të përgjithshme, që për lojtarin janë më të papërshtatshme në krahasim me ato që kanë qenë të zbatueshme në kohën e pranimi, lojtari ka të drejtë kërkojë mbylljen e llogarisë LK dhe daljen nga sistemi i organizimit.

Neni 25

Për gjithçka që nuk është paraparë në mënyrë të prerë me këto Rregulla të përgjithshme si dhe në rastet e keqpërdorimit eventual, do të zbatohen dispozitat pozitive juridike. Në rast të kontestit të mundshëm, që shkaktohet nga veprimi lidhur me këto Rregulla të përgjithshme, kompetente është Gjykata Themelore e Prishtinës.

Neni 26

Këto Rregulla hyjnë në fuqi ditën e publikimit në faqen e internetit të organizatorit, e do të zbatohen nga data 23.12.2013.

Lotaria e Kosovës
Drejtori
Bashkim Sllamniku